

VENDIM
Nr. 832, datë 19.12.2022

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2022, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT, PËR FINANCIMIN E VLERËS SË
TATIMIT MBI VLERËN E SHTUAR (TVSH) TË BILETAVE PËR NDESHJEN
FINALE TË *UEFA CONFERENCE LEAGUE*, TË ZHVILLUAR NË ARENËN
KOMBËTARE TË FUTBOLLIT TIRANË, NË DATËN 25 MAJ 2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, në zërin “Shpenzime korrente”, në artikullin 604 “Të tjera transferata korrente të brendshme”, të programit buxhetor “Zhvillimi i sportit”, i shtohet fondi prej 19 710 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e dhjetë mijë) lekësh, për financimin e vlerës së tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) të biletave për ndeshjen finale të *UEFA Conference League*, të zhvilluar në Arenën Kombëtare të Futbollit Tiranë, në datën 25 maj 2022.

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit i transferon Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) në llogarinë e saj në një bankë të nivelit të dytë, fondin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, pas përcjelljes nga ana e FSHF-së së dokumentacionit justifikues, në masën e shumës që transferohet.

3. FSHF-ja në zbatim të kushteve të kontratës së nënshkruar, në datën 21 mars 2021, ndërmjet saj dhe UEFA-s, për financimin e vlerës së tatimit mbi vlerën e shtuar të biletave për ndeshjen finale të *UEFA Conference League*, transferon nga llogaria e saj në një bankë të nivelit të dytë, në llogarinë e UEFA-s, fondin e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, pas konfirmimit të dokumentacionit justifikues, në masën e shumës që transferohet.

4. Efekti financiar, prej 19 710 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e dhjetë mijë) lekësh, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2022.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Federata Shqiptare e Futbollit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku